



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 315/5 prot.

Tiranë, më 7.8.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 766, datë 22.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Aliu
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.7.2024, është njoftuar vendimi nr. 766, datë 22.5.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 766, datë 22.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Aliu, ushtron detyrën e ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Aliu, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, (në vijim referuar si *KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ervin Aliu”,² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **AKSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.10.2017, të DSIK, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë **.10.2023, të KDZH-së, ka referuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu”.

2.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Ervin Aliu³.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] 37. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon:

- Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur në pronësi, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim.
- Mungesa e deklarimit të adresës së banimit të një apartamenti të përdorur prej tij e bashkëshortes, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3, të nenit 61, dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...] 42. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar[...].

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.4.2018.

³ Raport i KLGJ-së nr. ***/* prot., datë **.2.2023.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] 51. Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësit ligjor Ervin Aliu dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektiv dhe eficient në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë” [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë⁴ votash, ndër të tjera, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 766, datë 22.5.2024, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 766/2024 të Komisionit.

II.A - Vlerësimi lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit

10. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohet paraprakisht aspekt i zbatimit të ligjit, sa vijon:

10.1 Jurisprudenca e Kolegjit lidhur me shkakun ligjor të “cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë” ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë

⁴ Znj. Valbona Sanxhaktari, anëtare e trupit gjykues, ka votuar “kundër”, duke dalë me mendim në pakicë.

disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces.

10.2 Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh, nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimet në situatën e konfliktit të interesit, paafhtësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A - Gjetje në kontrollin pasuror

11. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar *Deklaratën e pasurisë* (në vijim referuar si D-Vetting) në datën **.1.2017, si dhe ka plotësuar Deklaratën e interesave privatë, në cilësinë e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***, ku ndër të tjera, ka deklaruar:

12. Lidhur me adresat e banimit dhe përdorimin e pasurisë “apartament me sip. 58.84 m²”

12.1 Në D-Vetting, në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në Gjendjen Civile”, subjekti ka deklaruar: “*Rruga *** ***, Pallati Nr. *, Shkalla *, Njësia Bashkiake Nr. *, Tiranë*”. Në rubrikën “*Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni*”, subjekti ka deklaruar: “*Durrës, Lagje Nr. *, Rruga ‘***, Pallati *** (***)*, Ap. **”.

12.2 Në DV-2015, në f. 13 të Deklaratës së interesave privatë të personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë: “*Lagjja ‘*** ***, Rr. ‘*** ***, Pallati i firmës ****, Ap *, *Shk. **”.

12.3 Në DV-2016, në rubrikën “*Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni*”, personi i lidhur me subjektin, ndër të tjera, ka deklaruar: *Tiranë, rruga ‘*** ***, pallati ‘***’, shk. * ap. *-**.

12.4 ILDKPKI-ja, në aktin përfundimtar të kontrollit nr. ***/** prot., datë **.4.2018, lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting”, ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar: (i) të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme; (ii) të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme; (iii) të kenë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme.

12.5 Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni se në cilat adresa ka banuar që nga momenti i marrjes së detyrës për herë të parë, lidhur me pronarin e objektit dhe nëse ka paguar qira, ka deklaruar se adresat ku kanë banuar janë: (1) Banesa e ndodhur në Durrës, Zona Kadastrale ***, Numri i Pasurisë */**+*-**, adresa: Lagjja Nr. *, Rruga “***”, Pallati nr. ***, Apartamenti **, deri në gusht 2019 dhe (2) banesa e marrë me qira, e ndodhur në ***-***, Tiranë, me adresë: Lagjja nr.**, rruga “*** **”, ndërtesa nr. *, Hyrja *, Ap. *, me pronar shtetasin ***, ***.

12.6 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, ndër të tjera, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti dhe

bashkëshortja ndër vite, të cilat duket se nuk janë pasqyruar nga subjekti i rivlerësimit në Pyetësorin nr.1, si dhe i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion për secilin rast të deklaruar.

12.7 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës **3.2024, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] Në lidhje me adresën e deklaruar: Rruga “*** **”, Pallati “***”, Shk. *, Ap.*-*, bëhet fjalë për banesën e ndodhur në ***, Tiranë, Zona Kadastrale ***, Numri i Pasurisë ***/***+*-**, pronarë të të cilës kanë qenë prindërit e mi, *** dhe *** ***. Qëndrimi në këtë apartament ka qenë sporadik, me ditë të caktuara dhe jo i përjavshëm, pasi, siç sqarova më lart, kam qëndruar në banesën e prindërve në Durrës në pjesën më të madhe të kohës [...].

12.8 Komisioni në vijim, pas zhvillimit të seancës dëgjimore me vendimin nr. *, datë **3.2024, për subjektin e rivlerësimit, vendosi: Të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu, me qëllim që të hetohet lidhur me adresat e banimit të deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

12.9 Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të dërguar, nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave të administruara pas rihapjes së hetimit, Komisionit, lidhur me adresën e banimit: Lagjja “*** **”, Rr. “*** **”, pallati i firmës ***, Ap. *, Shk.*., i ka rezultuar se: [...] duke u mbështetur në shpjegimet e subjektit përcjellë me prapësime, por edhe në deklarin e tij në DIPP 2015, duket se kjo banesë është përdorur prej tij dhe bashkëshortes së tij, por nuk është deklaruar prej tij gjatë procesit të rivlerësimit. Si rezultat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

12.10 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit shtesë, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] Ashtu siç e kam sqaruar dhe më parë, para këtij Komisioni, nga lidhja e martesës time në muajin shkurt 2013 e deri në muajin gusht 2018, unë dhe familja ime kemi qëndruar me ditë të caktuara në apartamentin në pronësi të prindërve të mi, të ndodhur në Tiranë, me adresë: Lagjja “*** **”, Rr. “*** **”, Pallati i firmës ***, Ap. *, Shk.* (kujtoj këtu shpjegimet ndaj gjetjeve të rezultateve të hetimit të KPK-së, njoftuar me email-in e datës **03.2024, në përgjigje të pyetjeve të bëra nga Komisioni, kam sqaruar se: “Në lidhje me adresën e deklaruar: Rruga “***. **”, pallati “***”, Shk. *, Ap.*-*, bëhet fjalë për banesën e ndodhur në ***. Tiranë, Zona Kadastrale ***, Numri i Pasurisë ***/***+*-***, pronarë të të cilës kanë qenë prindërit e mi, **** dhe ** ***. Qëndrimi në këtë apartament ka qenë sporadik, me ditë të caktuara dhe jo i përjavshëm, pasi, siç sqarova më lart kam qëndruar në banesën e prindërve në Durrës në pjesën më të madhe të kohës” ... për sa i takon faktit se kjo banesë nuk është deklaruar nga ana ime gjatë procesit të rivlerësimit tim, kërkoj të sqaroj se, në pyetësorin standard, unë i jam përgjigjur pyetjes: “Në cilat adresa keni banuar që nga momenti që keni marrë detyrën për herë të parë? Për secilën prej tyre, përcaktoni kush ka qenë pronari i objektit, a keni paguar qira dhe, nëse po, kujt ia keni paguar. Paraqisni dokumentacion provues”, sipas mënyrës se si e kam kuptuar pyetjen dhe në asnjë moment nuk kam pasur për qëllim që të mos e deklaroj gjatë procesit të rivlerësimit ... nga të gjitha rrethanat e parashtruara më sipër, si dhe provat në mbështetje të tyre, argumentohet se mosdeklarimi i adresës së apartamentit: Lagjja “*** **”, Rr. “*** **”, pallati i firmës “***”, Ap. *, Shk. *, në përgjigje të pyetjes nr.1, të formularit standard, është një pasaktësi (për shkak të mënyrës së si është kuptuar pyetja nga ana ime), dhe nuk ka asnjë qëllim tjetër [...].

12.11 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se: [...] *rezulton e provuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar si adresë banimi e, për pasojë, as e drejta e përdorimit të apartamentit në lagjen “**** **”, rr. “**** **”, pallati i firmës “****”, ap. *, shk. *. Pasaktësia në Deklaratën “Vetting”, lidhur me adresën e banimit dhe përdorimin e kësaj pasurie, është e vetmja gjetje e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë [...].*

12.12 **Komisioneri Publik**, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me sa konstatuar nga Komisioni mbi përdorimin dhe mosdeklarimin e pasurisë *apartament* me sip.58.84 m², ndodhur në lagjen “**** **”, rr. “**** **”, pallati i firmës “****”, ap. *, shk.*.

12.12.1 Sikurse është konstatuar dhe nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën “Vetting”⁵ si pasuri në përdorim *apartamentin* e ndodhur në rrugën “**** **” dhe as burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke shmangur kështu detyrimin ligjor të përcaktuar nga neni D i aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

12.12.2 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri as gjatë hetimit administrativ si pasuri në përdorim apo si adresë banimi, megjithëse rezulton të jetë pyetur nga Komisioni në Pyetësorin nr.1, lidhur me adresat e banimit (pyetja nr.1) dhe nëse ka përdorur pasuri në emrin e ndonjë personi tjetër në Shqipëri (pyetja nr.7).

12.12.3 Sa i takon pretendimit të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, se ai familjarisht, nga muaji shkurt 2013 deri në muajin gusht 2018, ka jetuar në banesën e prindërve në Durrës, konstatohet se ky pretendim nuk përputhet me deklaratimet e kryera nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratat periodike vjetore, për vitet 2013-2015, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e Kolegjit përbëjnë provë në këtë proces. Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratat periodike vjetore, për vitet 2013-2015, kanë deklaruar adresa të ndryshme banimi nga sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës.

12.12.4 Gjatë hetimit administrativ janë administruar një sërë aktesh juridike të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, që datojnë në periudhën 2014-2016, ku si adresë e subjektit është shënuar pikërisht apartamenti i ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë, si:

(i) Kontratë kredie bankare, datë **.6.2014, me *** Bank, për kredinë me shumë 500.000 lekë, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e bashkëkredimarrësit, si adresë banimi është shënuar: “**** **”, Rruga “**** **”, pallati “****”, nr. *, Shkalla *, Apartamenti *, Tiranë.

(ii) Kontratë kredie bankare, datë **.3.2016, me *** Bank, për kredinë me shumë 1.200.000 lekë, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e bashkëkredimarrësit, si adresë banimi është shënuar “**** **”, Rruga “**** **”, pallati “****”, nr. *, Shkalla *, Apartamenti *, **, Tiranë.

⁵ Rezulton se ligji nr.84/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 23.9.2016.

(iii) Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2016, për blerje automjeti, ku subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse, si adresë banimi ka shënuar rruga: “***”, *Tiranë*.

(iv) Veprim Juridik (shkresë e thjeshtë), që mban datën **.10.2016, me palë z. Ervin Aliu, me adresë rruga “***”, *Tiranë*.

12.12.5 Nga tërësia e këtyre akteve duket se subjekti i rivlerësimit, më së paku, gjatë periudhës 2014-2016, ka banuar në apartamentin e ndodhur në rrugën “***”, *Tiranë*.

12.12.6 Referuar legjislacionit për procesin e rivlerësimit dhe jurisprudencës së Kolegjit⁶ vlerësojmë se, nga leximi i kombinuar i dispozitave që rregullojnë deklarimin e pasurive në funksion të procesit të rivlerësimit nga subjektet, konkretisht pika 1 e nenit D të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, dhe përkufizimit të pasurive që i nënshtrohen deklarimit për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, rezulton qartë detyrimi i subjektit të rivlerësimit, për të deklaruar këtë pasuri, të cilën e kishte në përdorim prej vitesh në momentin e depozitimit të deklaratës së pasurisë. Po ashtu, pika 5 e nenit D të aneksit të Kushtetutës parashikon edhe sanksionin disiplinor, në kushtet kur një subjekt rivlerësimi fsheh apo paraqet në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedim e përdorim.

12.12.7 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik, nga tërësia e akteve të administruara në dosje, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” dhe as në pyetësorë përdorimin e pasurisë *apartament* me sip.58.84 m², rrethana të cilat të çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, më së paku, është përpjekur të paraqesë ndryshe, në mënyrë të pasaktë, përdorimin e këtij apartamenti, duke shmangur detyrimet ligjore që rrjedhin nga parashikimet e ligjit nr.84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim, duke u gjendur kështu në kushtet e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

13. Autoveturë tip “Mercedes Benz”, me targa ***

13.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Veprim juridik, datë **.10.2016, për shitblerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, nr. shasie ***, viti i prodhimit 1998, shitur për pjesë këmbimi. Shitësi Ervin *** Aliu. Vlera: 135,000 lekë. Pjesa takuese: bashkëpronësi bashkëshortore 1/2 pjesë.*

13.2 Në dosjen e Komisionit janë administruar: (i) Akt i titulluar “Veprim Juridik shkresë e thjeshtë”, i datës **.10.2016, në këtë akt citohet se, në datën **.10.2016, z. Ervin Aliu i shet z. *** ***, automjetin me targa të origjinës tashmë të çregjistruar, ***, me nr. shasie ***, e zhdoganuar pranë autoriteteve shqiptare, me deklaratën e zhdoganimit datë **.9.2016. Çmimi i shitjes do të jetë 135.000 lekë. Mjeti nuk është në gjendje të pranueshme pune dhe shitet për pjesë këmbimi. (ii) Kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2008, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit në shumën 5.500 euro.

13.3 DPSHTRR-ja nuk e ka konfirmuar regjistrimin e këtij automjeti në emër të subjektit të rivlerësimit.

⁶ Vendimi (JR) nr. 32/2022.

13.4 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.7.2021, ka konfirmuar se Ervin *** Aliu ka në pronësi 3 mjete, ndër to dhe mjetin me targa të huaja ***.

13.5 Lidhur me pagesën e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu, në *** Bank, rezulton se, në datën **.10.2016, në këtë llogari bankare është transferuar nga shtetasja *** *** (bashkëshortja e shtetasit ***. ***) shuma 135.000 lekë.

13.6 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i ka kërkuar shpjegime subjektit për faktin se nga analiza e pasurisë *autoveturë* me targa ***, e tipit “Mercedes-Benz”, blerë me kontratën nga Ervin Aliu, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2016, nga shitësi *** *** ***, në vlerën 140.000 lekë dhe pasurisë automjet “Mercedes-Benz”, nr. shasie ***, shitur për pjesë këmbimi nga shitësi Ervin Aliu, për vlerën 135,000 lekë, shtetasit *** *** ***, pasi duket se kemi të bëjmë me këmbimin e dy makinave dhe jo me shitje - blerje të mirëfilltë.

13.7 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Palët kanë qenë të lira që midis tyre të lidhnin si kontratë shkëmbimi, ashtu edhe kontrata shitblerjeje për tjetërsimin e automjeteve si më sipër, pasi që të dyja janë veprime juridike të ligjshme dhe të vullnetshme. Fakti që nga ana jonë janë lidhur kontrata shitblerjeje për secilin prej tyre kishte të bënte me kohën kur janë lidhur kontratat e shitjes dhe gjendjen teknike të secilit mjet. Mjeti i parë u ble nga ana ime për përdorim të përditshëm, pasi ishte në gjendje pune. Mjeti i dytë, konkretisht, ai tip ‘Mercedes-Benz’, nr. shasie ***, është shitur në bazë të bisedimeve të kryera midis palëve pas lidhjes së kontratës së parë dhe është blerë për pjesë këmbimi, pasi nuk ka qenë në gjendje pune”.*

13.8 Komisioni, në përfundim, krijoi bindjen se: [...] *këto veprime juridike kanë qenë reale dhe nuk krijojnë dyshime lidhur me deklarin e saktë dhe të mjaftueshëm të këtyre dy veprimeve juridike [...].*

13.9 **Komisioneri Publik**, në drejtim të analizës së fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ lidhur me pasurinë *autoveturë* tip “Mercedes Benz”, me targa ***, vlerëson të konsiderojë të dhënat e ankimit nr. 434/5 prot., datë 2.11.2023, të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 698, datë 15.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. ***. ***⁷.

13.10 Nga verifikimi i ankimit nr. 434/5 prot., datë 2.11.2023, në prg. 48 të tij dhe në vijim, rezulton se:

*Në dosjen e Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, ndër të tjera, janë administruar: (i) kontratë shitje e datës **.10.2008, me palë shitëse ***.***., me palë blerëse shtetasin ***.***., me objekt shitje automjeti Mercedes-Benz, me nr. shasie ***, për çmimin 5.500 euro; (ii) prokurë e posaçme e datës **.10.2012, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., ku shtetasi ***.***., në cilësinë e pronarit të automjetit autorizon subjektin e rivlerësimit, z. ***, të përdorë mjetin në fjalë për nevoja pune dhe familjare brenda dhe jashtë Shqipërisë, të paraqitet para çdo organi administrativ shtetëror për të bërë zhdoganimin e mjetit, të bëjë tjetërsimin (shitjen ose dhurimin) e këtij mjeti vetes apo personave të tretë, të bëjë nxjerrjen jashtë qarkullimit*

⁷ https://ikp.al/2023/11/02/ankim-kunder-vendimit-nr-698-date-15-9-2023-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-***-***/

sipas çmimit që do të gjykojë të arsyeshëm; (iii) shkresa e thjeshtë e datës **.10.2016, e nënshkruar nga shtetasi ***.***., në cilësinë e shitësit dhe subjekti i rivlerësimit, z. ***, në cilësinë e blerësit, ku palët bien dakord për shitjen e automjetit me targa të origjinës ** *** ** kundrejt çmimit 135.000 lekë; (iv) shkresa e DPSHTRR-së, ku thuhet se mjeti me targë ** *** ***, nuk figuron i regjistruar.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të datës **.4.2022, të shtetasit ***.***., i cili deklaron se automjetin në fjalë e ka blerë për nevoja personale dhe nuk ka arritur ta zhdoganojë, për shkak se disa ditë pas blerjes pësoi defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte dot. Gjithashtu, ky shtetas deklaron se tagrat e dhëna prej tij në prokurën e datës **.10.2012, me përfitues subjektin, z. ***, nuk u realizuan, përveç dy-tre rasteve kur automjeti ka lëvizur për efekt testimi për rregullim defekti, i cili nuk u rregullua dhe gjendja mbeti njësoj deri në shitjen përfundimtare për pjesë këmbimi.

13.11 **Komisioneri Publik**, sikurse ka konstatuar dhe në ankimin e mësipërm, vëren se, dhe në këtë rast, subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Aliu, që ka qenë palë në këtë marrëdhënie, ka pasur në përdorim për disa vite një automjet pa leje qarkullimi, të parregjistruar në DPSHTRR, si dhe nuk ka paguar detyrimet doganore lidhur me të.

13.12 Në rastin konkret, marrë në konsideratë dhe gjetjet e tjera të trajtuara në këtë ankim, në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14. Autoveturë tip “Mercedes Benz”, me targa ***

14.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë targa *** e tipit Mercedes Benz C klas 180, prodhim i vitit 1993, e blerë me kontratën nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.10.2016 (e blerë me të ardhurat e siguruara nga paga). Vlera 140.000 lekë.*

14.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit deklaron se: *Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim.*

14.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr.***/* prot., datë **.7.2021, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targë *** (targa e mëparshme ***). Bashkëlidhur kësaj shkrese janë administruar: (i) Kontratë shitje me nr. *** rep., dhe nr.*** kol., datë **.10.2016, me palë shitëse shtetasin *** *** dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, me objekt pasurinë *autoveturë* me targa ***, blerë nga subjekti kundrejt vlerës 140.000 lekë dhe (ii) Kontratë mbi shitjen e automjetit me nr. *** regj., datë **.5.2019, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe palë blerëse vëllait të tij, shtetasin *** ***, në vlerën 100.000 lekë.

14.4 Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu, në *** Bank, rezulton se, në datën **.10.2016, në këtë llogari bankare është transferuar nga shtetasja *** *** (bashkëshortja e shitësit) shuma 135.000 lekë. Një ditë më pas, në datën **.10.2016, vlera 140.300 lekë është transferuar në favor të shtetasës *** ***, me përshkrimin “pagesë për blerje automjeti ***” .

14.5 Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se subjekti, në Deklaratën “Vetting” ka shpjeguar se ky automjet është blerë me të ardhurat e siguruara nga paga. Në përfundim,

Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën **.10.2016.

14.6 **Komisioneri Publik**, referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, lidhur me pasurinë *autoveturë* tip “Mercedes Benz”, me targa ***, vëren sa vijon:

14.6.1 Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting”, nuk ka deklaruar burimin e saktë dhe faktik të krijimit të kësaj pasurie, pasi, referuar transaksioneve të kryera në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, në *** Bank, rezulton se si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie ka shërbyer shuma 135.000 lekë, e transferuar në llogarinë bankare të subjektit nga shtetasja *** ***, bashkëshortja e shtetasit *** ***.

14.6.2 Nga aktet në dosje rezulton se shuma 135.000 lekë, e transferuar nga shtetasja *** *** dhe që ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt analize, vjen nga Aktmarrëveshja për shitblerje automjeti (shkresë e thjeshtë), e datës **.10.2016, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit *** ***.

14.6.3 Sikurse është trajtuar dhe më sipër në këtë ankim, rezulton se, me prokurën e posaçme të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e pronarit të automjetit, me targa *** dhe nr. shasie ***, ka autorizuar shtetasin *** *** të përdorë mjetin në fjalë për nevoja pune dhe familjare, brenda dhe jashtë Shqipërisë, të paraqitet para çdo organi administrativ shtetëror për të bërë zhdoganimin e mjetit, të bëjë tjetërsimin (shitjen ose dhurimin) e këtij mjeti vetes apo personave të tretë, të bëjë nxjerrjen jashtë qarkullimit sipas çmimit që do të gjykojë të arsyeshëm⁸.

14.6.4 Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit i ka kaluar shtetasit *** *** të drejtën për të përdorur, shitur ose dhuruar këtë automjet që në vitin 2012, ndërkohë që, me shkresën e thjeshtë, të datës **.10.2016, deklarohet se ia ka shitur këtë automjet shtetasit *** ***, në shumën 135.000 lekë. Kjo shumë e përfituar nga transaksioni i mësipërm është transferuar nga bashkëshortja e shtetasit *** ***, në favor të subjektit, në datën **.10.2016 dhe vetëm një ditë më pas, në datën **.10.2016, vlera 140.300 lekë, është transferuar nga subjekti në favor të shtetasës *** ***, me përshkrimin: “Pagesë për blerje automjeti ***”.

14.6.5 Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit për një automjet, të drejtat e të cilit i ka transferuar që në vitin 2012, ka përfituar në vitin 2016 shumën 135.000 lekë. Kjo shumë duket se ka shërbyer si burim krijimi për automjetin me targa ***, një transaksion ky i kryer sërish me shtetasin *** ***.

14.6.6 Në përfundim të sa më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin faktik të krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa ***, si dhe duket se është përpjekur të paraqesë ndryshe situatën lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Komisioneri Publik çmon se rrethanat e mësipërme të konstatuara lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe gjetjet e tjera të trajtuara më sipër në këtë ankim që lidhen me pasurinë *automjetin*, me targë ***, duhen marrë në konsideratë, në një vlerësim tërësor të procedurave të rivlerësimit për subjektin, z. Ervin Aliu, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

⁸ Referohuni ankimit të Komisionerit Publik nr. 434/2 prot., datë 2.11.2023, prg. 48.2.

15. Depozitë bankare, pranë Bankës *** **

15.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë depozitë bankare pranë Bankës *** **, datë *.8.2015, në shumën 220,000 lekë, e vendosur si garanci e kredisë bankare e lehtësuar për blerje apartamenti nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë **.9.2012. Gjendja në datën **.1.2017 është 223,267 lekë, ku përfshihen interesat vjetore 2016. Kursime bashkëshortore, viti 2014.*

15.2 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur të znj. ***. ***, ka deklaruar: *Depozitë bankare, afati 1-vit, **.8.2015-**.8.2016, Banka ** ***, e lidhur në datë **.8.2015, e vënë si garanci për Kontratën e kredisë bankare, e lehtësuar për blerje apartamenti nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë **.9.2012 (e krijuar nga kursimet familjare e vitit 2014). Vlera 220,000 lekë.*

15.3 Nga informacioni i përcjellë nga Banka *** **, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.8.2021, rezulton se në llogarinë bankare të znj. ***. ***, në datën **.8.2015, është transferuar shuma 530,127.41 lekë, nga shtetasi *** ***. Nga kjo shumë 220,000 lekë janë kaluar në depozitë bankare, sikurse deklaruar më sipër nga subjekti, ndërsa diferenca në shumën 310,127.41 lekë është tërhequr *cash*.

15.4 Në Aneksin e Kontratës së Kredisë me nr. *** rep., dhe nr.*** kol., datë **.9.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit është ofruar si dorëzanës për të siguruar kontratën e kredisë datë **.19.2012, me nr.*** rep., dhe nr.*** kol., lidhur mes palëve. Kredimarrësi dhe Dorëzanësi sigurojnë bankën me anë të garancisë, përfaqësuar nga barrësimi i pasurisë “*Depozitë bankare në shumën totale 220.000 lekë*”, në favor të ***-së.

15.5 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin *** **, i cili nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se është bërë garant për marrjen e një kredie me afat 30 vjet, nga ana bashkëshortes së subjektit, duke lënë si garanci një depozitë bankare në shumën 500.000 lekë, si dhe ka dhënë një hua në shumën prej 500.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *[...] duke qenë se vjehrra ime aktuale, *** **, ishte përfutuese e një kredie të butë, dhe vlera e apartamentit nuk e mbulonte shumën e kërkuar për kolateral, përsëri me ndërhyrjen time, shtetasi *** **, meqë e kishte gjendje një depozitë në ***, aty ku kërkohej edhe kolaterali, e vuri si garanci për garantimin e kredisë, pasi nga ana ime, Ervin Aliu, i është bërë e ditur që kjo shumë do t'i kthehej sapo të na krijohej mundësia. Sa më sipër, Ju sqaroj se njihem dhe kam miqësi të hershme me z. *** **, prandaj dhe i jam drejtuar atij për ndihmë, në kushtet kur e dija se ai kishte mundësitë financiare për të më ndihmuar dhe me burime të ligjshme të pasurisë së tij [...].*

15.6 Referuar akteve në dosje të Komisionit, rezulton se shuma e transferuar nga shtetasi ***. ***, që në vijim ka shërbyer si burim krijimi për depozitën bankare në ***, janë fondet e depozitës bankare të vendosura si garanci nga shtetasi *** **. Lidhur me kontratën e dorëzansisë, e cila ka shërbyer në të njëjtën kohë për krijimin e llogarisë objekt shqyrtimi, në dosje të Komisionit janë administruar aktet si vijon: (i) Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.4.2014, ku *** *** deklaron se shuma e depozitës bankare, lënë si garanci për të siguruar kredinë bankare, do të paguhet në 5 këste, me nga 100 000 lekë çdo 45 ditë. Sipas kësaj deklarate, kësti i parë prej 100.000 lekë është paguar me nënshkrimin e kësaj deklarate. (ii) Deklaratë e thjeshtë, e datës **.7.2014, ku shtetasi *** *** deklaron se, deri në

këtë datë, janë kryer 3 pagesa në këmbim të depozitës 500.000 lekë, të vendosur si garanci për kredinë e marrë në *** Bank; (iii) Deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr.*** kol, datë **.12.2014, ku shtetasi *** *** ka deklaruar se ka marrë shumën prej 500.000 lekë, e cila i është paguar me këste jashtë kësaj zyre, në këmbim të depozitës bankare të tij nr. ***, në ***, prej 500.000 lekësh, e lënë si garanci për të siguruar kontratën e kredisë nr.*** rep., nr. *** kol.

15.7 Komisioni, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ka konstatuar se nuk rezulton që subjekti dhe/ose bashkëshortja të kenë kryer deklarime për pagesat e kryera nga *** *** gjatë vitit 2014, në total prej 500.000 lekë, dhe as pakësim likuiditetesh në këtë shumë sipas detyrimit ligjor.

15.8 Në vijim, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit për sa vijon: *Në përfundim rezulton se z. ***. *** duket të ketë qenë shoku juaj dhe ka garantuar një kredi që merrte znj. *** *** në vitin 2012 për blerje apartamenti për nënën e saj, e më vonë edhe një kredi të dytë për ju. Nga hetimi, nuk rezulton e qartë marrëdhënia e subjektit dhe znj. *** me huadhënësin z. *** ***, person tjetër i lidhur për shkak të huadhënieve.*

15.9 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime përfundimtare, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] ***. *** ka vendosur si garanci shumën prej 500.000 lekësh, në ***, për të garantuar kredinë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2012, të marrë në Bankën *** *** sh.a., të përfituar nga nëna e bashkëshortes, znj. *** ***, për blerjen e apartamentit nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.9.2012. Duke qenë se nga ana e tij u kërkuar të tërhiqej kjo shumë nga *** për ta përdorur për arsye personale, por nuk ishte e mundur për shkak të mosplotësimit të afatit për lirim e saj, atëherë ramë dakord që unë dhe bashkëshortja ime me kursimet tona nga pagat, hua nga *** *** (**), si dhe mjetet monetare të siguruar nga një kredi bankare konsumatore në *** Bank sh.a., në datën **.6.2014, t'ia jepnim cash këtë shumë me kushtin që të jepte pëlqimin për transferimin e depozitës së tij, të vënë garanci në ***, në favorin tonë. Në përfundim, shuma e depozituar në ***, prej 500 000 lekësh, mbeti në pronësinë time dhe bashkëshortes time, një pjesë e të cilës është tërhequr me qëllim shlyerjen e një pjese të mbetur nga huaja në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, sipas Deklaratës Noteriale Nr.*** Rep., Nr.*** Kol., datë **.06.2012 ... ashtu siç e kam shpjeguar edhe në përgjigje të Pyetësorit nr.2, unë, në muajin qershor 2012, kam qenë në lidhje me znj. *** ***, e cila më vonë u bë bashkëshortja ime. Në këtë periudhë, ajo kishte nevojë për një hua që i nevojitej për të shlyer një kredi bankare në *** Bank sh.a. E kemi diskutuar këtë problem së bashku. Nga ana ime, në ato momente, nuk e kisha mundësinë që ta ndihmoja. Në këto rrethana, mora përsipër që ta ndihmoja nëpërmjet një mikut tim, konkretisht shtetasit *** ***, i cili, në atë kohë, dispononte të ardhura të ligjshme, pasi kishte shitur pasuri të paluajtshme në vlera të konsiderueshme, dhe shuma e kërkuar hua ishte krahasimisht shumë e vogël në raport me të. Siç provohet nga Deklarata noteriale Nr. repertori: **, Nr. koleksioni: **, datë **.01.2021, lëshuar nga shtetasi *** ***, unë me të kam patur njohje dhe shoqëri të hershme, përpara se të njihesha me bashkëshorten time. Kurse kjo e fundit e ka njohur z. ***. *** nëpërmjet meje, si shokun tim, prandaj çdo veprim midis tyre është kryer në mirëbesim, duke qenë unë personi që i garantoja mbi korrektësinë e njëri-tjetrit. Po ashtu, duke qenë se vjehrra ime aktuale, *** ***, ishte përfituese e një kredie të butë, dhe vlera e apartamentit nuk e mbulonte shumën e kërkuar për kolateral, përsëri me

*ndërhyrjen time, shtetasi *** ***, meqë e kishte gjendje një depozitë në ***, aty ku kërkohet edhe kolaterali, e vuri si garanci për garantimin e kredisë, pasi nga ana ime, Ervin Aliu, i është bërë e ditur që kjo shumë do t'i kthehej sapo të na krijohet mundësia. Sa më sipër, Ju sqaroj se njihem dhe kam miqësi të hershme me z. *** ***, prandaj dhe i jam drejtuar atij për ndihmë, në kushtet kur e dija se ai kishte mundësitë financiare për të më ndihmuar dhe me burime të ligjshme.*

15.10 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se nuk ngrihen dyshime lidhur me marrëdhënien e subjektit dhe të personit të lidhur në raport me shtetasin ***. ***, dhe huat e marra prej tij, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit.

15.11 **Komisioneri Publik**, referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, lidhur me depozitën bankare në ***, konstaton sa vijon:

15.11.1 Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting” dhe në DV- 2015 (në cilësinë e personit të lidhur me detyrim për deklarim), ka deklaruar depozitën bankare në shumën 220.000 lekë në ***, duke deklaruar si burim krijimi kursimet familjare të vitit 2014.

15.11.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka rezultuar se, ndryshe nga sa deklarohet nga subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi për këtë depozitë ka shërbyer transferta bankare e kryer nga shtetasi *** *** dhe jo kursimet familjare të vitit 2014.

15.11.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ dhe në shpjegime përfundimtare, ka deklaruar dhe ka paraqitur disa deklarata noteriale të shtetasit *** ***, ku, ndër të tjera, deklarohet se garancia në shumën 500.000 lekë, e vënë nga shtetasi *** ***, është shlyer në vitin 2014.

15.11.4 Nga analizimi i DV-2014⁹ nuk rezulton të jetë deklaruar shlyerje e huas kundrejt shtetasit *** *** dhe as burimi i fondeve që kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj shume.

15.11.5 Gjithashtu, duket jo i arsyeshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga shuma që u transferua nga shtetasi ***. ***, në favor të personit të lidhur, një pjesë e kësaj shume është përdorur për të shlyer një hua po kundrejt këtij shtetasi. Gjithashtu, mbetet e paqartë arsyeja e dhënies së shumës 500.000 lekë shtetasit ***. ***, në vitin 2014 dhe përfitimi i depozitës bankare të tij nga subjekti dhe personi i lidhur në vitin 2015, në kushtet kur subjekti mund të krijonte vetë një depozitë bankare në shumën 500.000 lekë, në vitin 2014, me fondet e pretenduara si të kthyera shtetasit ***. ***. dhe të çlironte garancinë e këtij të fundit.

15.11.6 Në përfundim të sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me burimin e krijimit të depozitës në shumën 220.000 lekë, në Bankën *** ***, si dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë rrethanat lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk ka deklaruar shlyerjen e shumës 500.000 lekë, në vitin 2014, dhe burimin e krijimit të kësaj shlyerje. Për pasojë, deklarimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke qenë kontradiktore dhe jo bindëse, nuk kënaqin kërkesat e nenit D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës.

16. Në përfundim, Komisioni Publik vlerëson se problematikat e konstatuara më sipër janë të vlefshme për t'u trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të

⁹ Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka dorëzuar Deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, ku ka deklaruar në cilësinë e personit të lidhur të znj. *** *** (***).

ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

IV. Kërkimi i ankimit

17. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

18. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

19. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 2, dhe nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

20. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 766, datë 22.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu.*

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO